

## BUKURESHT - TRANSILVANI Nisje: • 20 Maj

DESTINACIONI

Bukuresht

PERIUDHA

Prill-Maj '2026

KOHËZGJATJA

4 Ditë

TRANSPORTI

Me Avion

## PËRMBLEDHJE

JUL

17

MAJ 2026



Nisje 20 Maj - Kthim 23 Maj

- 3 Ditë / 2 Netë
- Çmimi: **399€**
-  Nisja: 11:40 (Tiranë) → 14:05 (Bukuresht)
-  Kthimi: 10:45 (Bukuresht) → 11:15 (Tiranë)

1

**Dita 1: BUKURESHT**

DITË

Nisja nga aeroporti i Tiranës me fluturim direkt Tirane – Bukuresht (1 ore : 20 min)

Mbërritja në Bukuresht është fillimi i një udhëtimi të paharrueshëm. Menjëherë pas pritjes nga udhëheqësi i grupit, nisim turin panoramik në qytetin historik, ku do të shijoni atmosferën unike të kryeqytetit rumun.

- **Pallati i Parlamentit (Palatul Parlamentului)** – Një ndërtesë imponante dhe simbol i qytetit, që reflekton historinë dhe madhësinë arkitektonike të Bukureshtit.
- **Qendra Historike Lipsçani** – Rrugicat e ngushta me kalldrëm, dyqanet artizanale, kafetë tradicionale dhe galeritë e vogla krijojnë një ambient të veçantë për shëtitje dhe fotografi.
- **Kisha Stavropoleos** – Një perle e arkitekturës ortodokse, e njohur për ikonat dhe detajet e bukura të brendshme.



Pas vizitave akomodimi në hotel 4★ në Bukuresht

2

**Dita 2: BUKURESHT**

DITË

Kjo ditë është e rezervuar për të zhytur veten në historinë dhe kulturën e Bukureshtit, duke vizituar muze dhe vende ikonike, por edhe duke shijuar atmosferën e qytetit në mënyrë të qetë.

- **Muzeu Kombëtar i Historisë së Rumunisë** – Një koleksion i pasur artefaktesh dhe dokumentesh historike që tregojnë rrugëtimin e Rumunisë gjatë shekujve.
- **Muzeu Satësor Dimitrie Gusti** – Një shëtitje në fshatrat tradicionale rumune, ku mund të shihni shtëpi tipike dhe të mësoni për traditat e jetës rurale.
- **Parku Carol** – Një hapësirë e gjelbër dhe e qetë për pushim dhe fotografi.
- **Ateneum Rumun (Ateneul Român)** – Një ndërtesë ikonë e arkitekturës, ku shpesh mund të ndiqni edhe koncerte muzikore.
- **Sheshi Revolucionit dhe rrugicat e Lipsçanit** – Kohë e lirë për të eksploruar qytetin, për suveniresh ose për një kafe të këndshme.
- **Darkë tradicionale rumune** – Përfundoni ditën me një darkë që sjell shijet autentike të kuzhinës vendase.

Një ditë e tërë aventurash dhe peizazhesh të bukura e pret grupin në Transilvani, duke filluar nga malet e Sinaia-s dhe duke përfunduar në qytetin mesjetar të Braşov-it.

- **Sinaia - Kështjella Peleş** - Një nga kështjellat më magjepsëse në Evropë, e rrethuar nga pyje alpine dhe kopshte të mrekullueshme. Udhëheqësi do t'ju tregojë historinë mbretërore dhe sekrete të brendshme të kështjellës.
- **Braşov - Piazza Sfatului dhe Kisha e Zezë** - Një qytet mesjetar ku rrugicat e kalldrëmuara, sheshet historike dhe ndërtesat e bukura ju ftojnë për një shëtitje relaksuese dhe fotografi të paharrueshme.
- **Castelul Bran (Kështjella e Drakulës)** - Një ndër vendet më të njohura në Rumani, e rrethuar nga legjenda e Drakulës. Kjo vizitë ofron një kombinim të historisë dhe misterit në një përvojë të veçantë.
- Kohë e lirë në **qendrën historike të Braşovit** - për suveniresh, kafene ose për të shijuar atmosferën e qytetit mesjetar.
- **Rikthim në Bukuresht** - Një mbrëmje e qetë pas një dite plot aventura dhe pamje mahnitëse.

- Mëngjesi dhe check-out nga hoteli.
- Transferimi në Aeroportin Henri Coandă për fluturimin e kthimit.
- Largimi nga Rumania me kujtime të paharrueshme nga Bukureshti dhe Transilvania, (një gershetim i historisë, kulturës me peizazhet magjepsëse).

## ÇFARË PËRFSHIHET

### ✓ PËRFSHIHET

- ✓ Udhëtimi vajtje-ardhje me avion Tiranë - Bukuresht - Tiranë. Transfertat dhe Shëtitjet me autobus sipas programi Akomodimi në hotel 4 Yje për 3 netë në Bukuresht Mëngjeset për të gjitha ditët e udhëtimit. Shoqërues shqiptar gjatë qëndrimit jashtë Shqipërisë. Lejohet të merret me vete në avion vetëm një çantë me përmasa deri në 40 x 30 x 20cm. (Kujdes - Mbi këto përmasa dhe Bagazh për checkin ka shpenzime ekstra).

### × NUK PËRFSHIHET

- × Drekat dhe Darkat gjatë udhëtimit Biletat e hyrjes në Muze dhe Monumente Turistike Taksat e qyteteve (paguhen në reception pas check out nga hoteli)

**VENDTAKIMI I NISJES**

► Nga aeroporti Nënë Tereza, ku duhet të paraqiteni minimumi 2 orë përpara

**POLITIKAT E ÇMIMIT PËR FËMIJËT**

► Fëmijët në moshën 2 - 11.99 vjeç përfitojnë 40€ zbritje nga cmimi i paketës

Shenim: Kjo politike hyn ne fuqi vetëm nëse femijët akomodohen në dhomë me 2 të rritur.

**DOGANA**

1) Pashaportë me vlefshmëri minimumi 3 muaj

2) Nuk duhet të keni kaluar në 6 muaj e fundit më shumë se 90 ditë qëndrimi në vendet e BE

**INFORMACIONE**

- Akomodimi në dhomë teke (single) është me ekstra pagesë në vlerën 30% mbi çmimin për person.
  - Nëse krevati nuk do të jetë dopio, atëherë do të jenë dy krevatë teke të bashkuar.
  - Nëse shtrati për personin e tretë/katërt nuk do të jetë standart, atëherë do të jetë sofa bed (shtrat i shtuar në dhomë).
  - Operatori Turistik nuk mban përgjegjësi për personat e kthyer nga policia për arsye të ndryshme sic janë mungesë dokumentacioni, ekspuls, skadenca e mjetit identifikues, etj.
  - Nëse nuk i keni mbushur 18 vjeç dhe udhëton pa praninë e njërit ose asnjërit prej prindërve, ju nevojitet prokurë e noterizuar në gjuhën angleze.
  - Ekziston mundësia që disa nga përmbajtjet e hotelit/udhëtimit të mos jenë aktualisht në funksion për shkak të rrethanave objektive, të cilat operatori nuk mund të ndikojë.
  - Çmimet dhe disponueshmëria e muzeumeve, ekskursioneve dhe cdo aktivitet tjetër lokal mund të ndryshojnë dhe janë përgjegjësi e vetë Operatorëve Lokale që mundësojnë këto shitje.
- Për cdo ndryshim në lidhje me këto aktivitete, klienti lajmërohet përpara kryerjes së shërbimit.

**INFORMACIONE**

|                |                         |
|----------------|-------------------------|
| DESTINACIONI   | <b>Bukuresht</b>        |
| TRANSPORTI     | <b>Me Avion</b>         |
| ÇMIMI          | <b>€399.00 / person</b> |
| ZBRITJE FËMIJË | <b>97% (€10.00)</b>     |

